



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

**RREGULLORE MD-NR. 03/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE
NDRYSHIMIN E RREGULLORES MD - Nr.07/2023 PËR PROCEDURËN
E PËRCAKTIMIT DHE VERIFIKIMIT TË RECIPROCITETIT,
KUSHTET, PËRMBAJTJEN DHE MËNYRËN E
MIRËMBAJTJES SË BAZËS SË TË DHËNAVE PËR FITIMIN E TË
DREJTËS SË PRONËSISË MBI PRONËN E PALUAJTSHME NGA TË
HUAJT NË KOSOVË¹**

¹ Rregullore MD Nr. 03/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores MD - Nr.07/2023 për procedurën e përcaktimit dhe verifikimit të reciprocitetit, kushtet, përmbajtjen dhe mënyrën e mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për fitimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën e paluajtshme nga të huajt në Kosovë, i nënshkruar nga Ministria e Ministrisë së Drejtësisë me datë: 26.02.2024.

Ministrja e Ministrisë së Drejtësisë,

Në mbështetje të nenit 10 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 dhe 1.2) të Ligjit nr. 08/L-013 për të Drejtat Pronësore të Shtetasve të Huaj në Republikën e Kosovës, në pajtim me nenin 11, (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në bazë të Shtojcës 1 (pika 3) të Rregullores QRK-nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, si dhe në pajtim me nenin 38 (paragrafi 6) të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare Nr. 15, 12.09.2011),

Nxjerr:

RREGULLORE NR. 03/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES MD - Nr.07/2023 PËR PROCEDURËN E PËRCAKTIMIT DHE VERIFIKIMIT TË RECIPROCITETIT, KUSHTET, PËRMBAJTJEN DHE MËNYRËN E MIRËMBAJTJES SË BAZËS SË TË DHËNAVE PËR FITIMIN E TË DREJTËS SË PRONËSISË MBI PRONËN E PALUAJTSHME NGA TË HUAJT NË KOSOVË

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores MD-Nr.07/2023 për procedurën e përcaktimit dhe verifikimit të reciprocitetit, kushtet, përmbajtjen dhe mënyrën e mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për fitimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën e paluajtshme nga të huajt në Kosovë (më tutje: Rregullorja bazë).

Neni 2

Pas nënparagrafit 1.3 të nenit 3 të Rregullores bazë shtohet nënparagrafi i ri 1.4 me tekstin si në vijim:

1.4. **Autoriteti përgjegjës** - Noteri që vepron në komunën përkatëse në të cilën gjendet paluajtshmëria.

Neni 3

Neni 5 i Rregullores bazë riformulohet me tekstin, si në vijim:

1. Procedura e përcaktimit të reciprocitetit zhvillohet në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi për procedurën e përgjithshme administrative dhe legjislacionin përkatës në fuqi për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës.
2. Pas krijimit të reciprocitetit me shtetin përkatës, Ministria e Drejtësisë nxjerr vendim me të cilin konfirmon reciprocitetin me shtetin përkatës.

Neni 4

Paragrafët 2.3, 2.4 dhe 2.5 të nenit 6 të Rregullores bazë fshihen.

Neni 5

Paragrafi 1 dhe 3 i nenit 7 të Rregullores bazë, riformulohen si në vijim:

1. Autoriteti përgjegjës, me qëllim të kompletimit të të dhënave, i dërgon kërkesë Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK) me të cilën kërkon të dhëna për pronën e pa luajtshme, e cila është objekt i kërkesës për fitimin e pronësisë nga i huaji.

3. Agjencia Kadastrale e Kosovës i dërgon të dhënat të cilat i posedon. Të dhënat nga nën paragrafi 2.3 të këtij neni, që nuk i posedon Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe të dhënat tjera të nevojshme për përcaktimin e reciprocitetit, autoriteti përgjegjës i kërkon nga institucionet tjera përkatëse publike qendrore dhe lokale në Republikën e Kosovës.

Neni 6

Paragrafi 2 i nenit 8 të Rregullores bazë, riformulohet si në vijim:

2. Informatat nga paragrafi 1 i këtij neni, Ministria i merr me kërkesë në shtetin e të huajit, ose përmes burimeve zyrtare.

Neni 7

Nënparagrafi 1.3 i nenit 13 të Rregullores bazë fshihet.

Neni 8

Nënparagrafi 1.1 i nenit 18 të Rregullores bazë ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

1.1. Shtojca Nr. 1: Kërkesë për përcaktimin e reciprocitetit për fitimin e të drejtës së pronësisë në pronë të paluajtshme në Republikën e Kosovës.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albulena Haxhiu

Ministre e Drejtësisë

26/02//2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë -Ministarstvo Pravde- Ministry of Justice

**KËRKESË PËR PËRCAKTIMIN E RECIPROCITETIT PËR FITIMIN E
TË DREJTËS SË PRONËSISË NË PRONË TË PALUAJTSHME NË
REPUBLIKËN E KOSOVËS**

Të dhënat e parashtruesit të kërkesës:

Emri dhe mbiemri i personit fizik/emri i personit juridik	
Adresa e banimit apo vendqëndrimit/selia	
Numri identifikues	
Shtetësia	
Tel. / e-mail	

Vërejtje / të dhëna shtesë të parashtruesit të kërkesës:

Në _____

Data _____

Nënshkrimi parashtruesit të kërkesës /të autorizuarit

Kërkesës së shkruar duhet bashkëngjitur:

1. Dëshminë për shtetësinë e fituesit të drejtës së pronësisë, si kopja e vërtetuar e pasaportës apo dëshmia për statusin e personit juridik- dokumentin nga regjistri i regjistrimit, dokumentet kur pala nuk ka shtetësi apo ka shtetësi të dyfishtë, apo dokumentet tjera të nevojshme siç përcaktohet me këtë Rregullore.
2. Nëse parashtruesin e kërkesës e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar, është e nevojshme të bashkëngjis autorizimin në origjinal apo kopjen e vërtetuar.

*Nëse është e nevojshme pala mund të ftohet që brenda afatit të caktuar të bashkëngjes edhe dokumente tjera, siç përcaktohet në legjislacionin përkatës në fuqi.